

Projekti: “Resurset territoriale te Vreshtarise dhe Veretarise Autoktone ne Shqiperi”

Periudha e raportimit:	Gusht 2010 – Dhjetor 2014
Agjencia Financuese:	AKTI
Agjencia Zbatuese:	FDA
Zona e implementimit:	Tepelene-Mallakaster, Permet, Leskovik, Tirane, Durres , Lezhe, Shkoder.
Vlera totale e projektit:	9,925,000

**Projekti: “Resurset territoriale te Vreshtarise
dhe Veretarise
Autoktone ne Shqiperi”
Qellimi i pergjithshem:**

Identifikimi dhe vleresimi i resurseve territoriale te eko-sistemit viti-vinikol ne Shqiperi, per shfrytezimin e tyre praktik per qellime ekonomike-prodhuese, eno-gastronomike dhe eko-turistike.

Objektivat e projektit

Objektivi 1:

- Identifikimi i vatrave te lashta te eko-sistemit vitikol dhe te agro- eko-sistemeve territoriale ne disa zona me vreshtari tradicionale.

Rezultatet:

- Gjeografia – shtrirja dhe vleresimi i karakteristikave mjedisore -ekologjike te tyre.
- Karakterizimi agro-ekologjik dhe i peisazhit “terroir” me potential per zhvillimin e promovimin e produkteve “bio” te nikies.

Objektivat e projektit

Objektivi 2:

- Struktura biologjike dhe vleresimi agro-ekonomik i germoplazmes autoktone ne territoret e vleresuara.

Rezultatet :

- Fondi i resurseve gjenetike me interes ekonomik – teknologjik.
- Mundesite e prodhimeve autoktone tipike te produkteve shqiptar DOC, IGT dhe sidomos te produkteve lokale “bio”.

Objektivat e projektit

Objektivi 3:

- Vleresimi teknologjik i strukturave autoktone ne kuadrin e prodhimit territorial te nje ekosistemi viti-vinikol “Genius Loci”. Sinergjia e sistemit Terroir-Prodhim”.

Rezultati 1:

- Ndertimi i *hartave* teknologjike per prodhime tipike territoriale dhe te nikes.

Rezultati 2:

- Struktura varietore te agro- ekosistemit per disa teritore tipike te cilat krijojne bazen e prodhimeve cilesore te markes shqiptare.

Si perputhet projekti me politikat dhe strategjite?

Projekti:

- Eshte ne sinkron me objektivat kryesore te strategjise se MBUMK per zhvillimin e sektorit te vreshtarise dhe veres per periudhen 2005-2015, nepermjet shtimit te siperfaqes se vreshtave me varietete lokale per prodhimin e vererave autoktone dhe me garanci te origjines.
- Eshte ne linje me nje nga fokuset e programeve te AKTI – it: “Mjedisi dhe biodiversiteti”.
- Mbeshtet dhe promovon ruajtjen, perdorimin dhe menaxhimin e biodiversitetit, duke perfshire zonat qe dallohen per biodiversitet te larte te hardhise.

Objekti i studimit

- Zona kodrinore e rrjedhjes se mesme te lumit Erzen: masivi Shesh-Pinet-Calaberzez-Eminas), e shtrire ne lartesine 300-500 m mbi nivelin e detit, me pamje drejt Gjirit te Durrresit dhe Ishmit. Kjo zone, historikisht me fshatrat Eminas, Shetel, Cezmelie, Calaberzez, Pinet, Sauqet dhe Shesh, te vendosur ne anen e djathte te rrjedhjes se Erzenit, paraqet sitin historik te lindjes dhe kultivimit te dy land-racave te hardhise autoktone Shesh i Bardhe dhe Shesh i Zi, e dokumentuar dhe nga burimet e deshmit e lashtesise (Colemella, Plini, Varoni, Virgili, etj.);
- Pellgu i kodrinave te lumit Vjose-Luftinje (Marice-Bylish-Kashishte), te vendosura ne lartesite 400-600 m mbi nivelin e detit. Kjo zone eshte me tradita lokale ne vreshtari dhe gjurme te lashta te civilizimit vitikol, e per pasoje paraqet interes te vecante per zhvillimin e ardhshem te nje vreshtarie dhe

Drejtimit kryesore te punes

- Eksplorim i drejtperdrejte i territorit fizik, per njohjen e detajuar te strukture rurale, rrjetit rrugor, vecorite agrare dhe ekonomike te qendrave te banuara, tiparet e peisazhit, shkalla e demtimit, burimet e mundshme te demtimeve, tendencat e veprimtarise ekonomike (agrare, familjare, agro-perpunuese, shkalla e investimeve dhe niveli i tyre, interesimi i komunitetit per kahun e zhvillimit, etj.
- Vleresim i mundesive te zgjerimit progresiv te siperfaqeve me vreshta dhe i shkalles se pershtatjes te plantacioneve ekzistuese me masivet e reja.

Drejtimitet kryesore te punes

- Ekzistenca e burimeve njerezore dhe ekonomike per nje zgjerim, perqendrim dhe specializim lokal nderkomunal, per sektorin e vreshtarise dhe veretarise, shoqeruar me veprimtari te tjera te rendesishme sikurse jane ullishtaria, bimet etero-vajore dhe medicinale, pemetaria e specializuar dhe e tipizuar (lajthi, qershi, arra,etj).
- Vendosje e bashkepunimit te qendrueshem dhe afat-gjate me dy kryeqendrat viti-vinikole te organizuara privatisht nga kantinat Kokomani (Eminas-Durres dhe Zikaj (Bylysh, Memaliaj, Tepelene).

Aktivitetet e realizuara referuar planit te veprimit

- Identifikimi i territorit ku do te shtrihej projekti (Gusht –Dhjetor 2010).
- Hartimi i protokollit te punes dhe i pyetesorit baze per 20 ekonomi te interesuara dhe te vleresuara si te pershtatshme per perfshirje ne kete projekt. (Tetor-Dhjetor 2010) .
- Ndertimi i skedareve per vleresimin e potencialit prodhues viti-vinikol, nga ku do te nxirreshin te dhena me te fokusuara per izolimin e vatrave ‘Locus geni’, me objektiv prodhimin e vererave DOC, DOCG dhe IGT te markes lokale autoktone, konform legjislacionit te KE dhe ate shqiptar te perafruar. (Janar-Shkurt 2011).

Aktivitetet e realizuara referuar planit te veprimit

- Ndertimi i deskriptoreve varietore te popullatave dhe land-racave te hardhive autoktone, kryesisht Sheshit te Zi, Sheshit te Bardhe, Pulezit te Bardhe, Pulezit te Zi dhe i disa popullatave shoqeruese me interes per te ardhmen (gjithsej 12) (Mars-Shtator 2011).
- Grumbullimi dhe perpunimi i te dhenave baze ne keto terriore per: strukturen gjeografike, orografike, hidrologjike dhe floristike (Prill 2011- Shkurt 2012).
- Treguesit klimatike baze, prej te cilave do te perpunohen indekset specifike viti-vinikole te Fregonit, Huglin, Hidrotermik, Pluviometrik. (2010-2014).
- Karakterizimi agro-pedologjik i territorit ne baze te te dhenave te analizes fiziko-kimike te tokave ne zonat e zgjedhura (2010-2014).

Aktivitetet e realizuara referuar planit te veprimit

- Te dhenat demografike si baze per njohjen e potencialeve humane per veprimtarite viti-vinikole te zonave.
- Te dhena ekonomike per siperfaqet aktuale te kultivuar me kulturat kryesore te interesuara, veprimtari te tjera agro-industriale, sherbime, agro-perpunim.
- Vleresimi i ndotjes se shkalles mjedisore ne territor (prania dhe karakteri i shperndarjes se mbetjeve urbane, shtazore, agro-industriale dhe i veprimtarive te tjera ndotese si makineri industrial, ndertuese, kimike, sanitare, etj. (2010-2014)

Aktivitetete shtese

- Vleresim agro-biologjik dhe fenologjik i hardhive tipike, perfaqesuese te popullates ose land-races nga Sheshi i Bardhe, Sheshi i Zi, Pulezi i Bardhe, Pulezi i Zi. Kryqezimet origjinale te Prof. Petraq Sotirit, KallmetxKabernet Sauvignon, KallmetxShesh i Zi, KallmetxVlosh, KallmetxAlikant Bushe' (koeficientet dhe indekset e prodhuesmerise relative dhe absolute, fenofazat e celjes se sytheve, lulezimit dhe pjekjes), potenciali prodhues dhe permbajtja e sheqerit, aciditetit dhe alkolit.
- Shenimi dhe vecimi i kloneve nga te cilet ne fazen e dyte te projektit (Janar 2011–Shkurt 2013) , u morr material shumezimi per prodhim fidanash dhe mbjellje vreshti te ri ne Eminas dhe Bylysh. Keto parcela pilot do t'u sherbejne ekonomive per zgjerimin e metejshem te siperfaqeve me vreshta te reja vetem me varietetet tona autoktone, te seleksionuara, permiresuara dhe certifikuara nga Enti Kombetar i Farerave dhe Fidanave, si baze per prodhimin e qendrueshem te vererave autoktone tipike te markes shqiptare.
- Ngritja e nje sere me siperfaqe te mbuluar 480 m2 ne ekonomine Zikaj, ku do te realizohet demonstrimi i teknologjise se prodhimit te fidanave te shartuar te hardhise nga land-racat autoktone.

Kontributet specifike te projektit

- Identifikimi i territoreve “Genius Loci” me perqendrim te njohur vlerash ekologjike, mjedisore, peisazhiste dhe historike-kulturore, ku mund te instalohen veprimtari te mirefillta te prodhimeve viti- vinikole, autoktone me tipicitet dhe marke shqiptare, ne menyre te drejtuar dhe te monitoruar;
- Sistemimi i te dhenave baze per hartimin e projekteve te specializuara ne varesi te eko-sistemeve lokale dhe “terroir”, te cilet do te sherbejne si baze e sigurte per suksesin dhe qendrueshmerine e investimeve ne produktet viti-vinikole te vendit;
- Integrimi i vlerave unikale te germoplazmes vitikole shqiptare, ne pasurine europiane, me qellim promovimin e saj ne arenen nderkombetare si veprimtari ekonomike fitimprures, social- kulturore , tradicionale, tipike shqiptare;

Kontributet specifike te projektit

- Hartimi i skemave eko-teknologjike, per harmonizimin e veprimtarise ekonomike -prodhuese me mbrojtjen, permiresimin, ekspozimin e vlerave te mjedisit rrethues, panorames dhe vlerave te tjera historike, arkeologjike, kulturore, etnografike, dhe eno-gastronomike;
- Rritja e sigurise ushqimore te disa produkteve jetike te perditshme, si rrushi, lengjet, mushtet, pekmezi, pijet alkolike, dhe sidomos vererat me gamen e gjere te perdorimit dhe konsumit te tyre, duke synuar ne produkte "bio" dhe te nikes, me verera autoktone te markes DOP-IGP;

Kontributet specifike te projektit

- Sqarimi i vijes se demarkacionit midis nderhyrjes per shfrytezimin e potencialeve mjedisore, territoriale, peisazhiste dhe biologjike, brenda kufijve te tolerances dhe sigurise se kesaj veprimtarie sa komplekse aq edhe te domosdoshme per zonat bujqesore kodrinore e malore te vendit tone, me zhvillimet e ardhshme bujqesore, agro-turistike dhe kulturele.
- Ndertimi i nje strategjie te re ne fushen e vreshtarise dhe veretarise cilesore, autoktone, hallkat kryesore te se ciles do te jene:
 - ❖ Specializimi dhe tipizimi i vererave tona;
 - ❖ Zbulimi, vleresimi dhe perqendrimi i prodhimeve tona autoktone te markes DOP-IGP;
 - ❖ Integrimi i vererave autoktone ne tregun global.

- JU FALEMINDERIT PER VEMENDJEN!